



Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Zyra e Komunikimit

440 N. Broad Street, Suite 102 ~ Philadelphia, PA 19130-4015 ~ (215) 400-4040

PER NJOFTIM TE MENJEHERSHEM

Kontakt: Deirdre Darragh
215-400-5787

17 Korrik 2013

NJOFTIM I MEDIAS

Vlerësimi dhe Regjistrimi Special për Imigrantët e Rinj do të fillojë në Gusht

FILADELFA- Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ju bën me dije që nga data 5 Gusht deri në datën 30 Gusht, familjet me fëmijë që kanë ardhur rishtaz në USA, mund të plotësojnë procesin e regjistrimit të nxënësve të rinj, me mbështetje të shërbimeve të përkthimit dhe interpretimit nga Qendra e Vlerësimit Shumëgjuhësh të Drejtorisë Arsimore (MAC) me adresë 440 North Broad Street, 1st Floor, Suite 1195.

Personeli do të jetë i gatshëm të drejtojë prindërit në të gjithë procesin e regjistrimit, të testojë fëmijët për njohuritë e gjuhës Angleze (ESOL), dhe të plotësojë të gjithë informacionin dhe burimet e nevojshme për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

Vitin e kaluar, Qendra MAC vlerësoi dhe regjistroi më shumë se 800 nxënës, përfshirë nxënës nga 70 vende të botës, të cilët flisnin më shumë se 40 gjuhë të ndryshme. Nxënësit që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha Angleze, janë të mirëpritur në mjediset e MAC_ut, që të kërkojnë asistencë në procesin e vlerësimit dhe regjistrimit.

Ju lutemi kontaktoni Qendrën e Vlerësimit Shumëgjuhësh të Drejtorisë Arsimore (MAC) në numrin e telefonit 215-400-4240 (Opsioni 1) për informacion të mëtejshëm dhe/ose të planifikoni një takim.

ÇFARE: Asistencë për regjistrim për familjet me fëmijë të ardhur rishtaz në USA

KU: 440 North Broad Street, 1st Floor, Suite 1195

KUR: 5 Gusht – 30 Gusht 2013

Nga e Hëna-Të Premte 8:30am-6:00pm

###